



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

KËSHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS SEMAN



VENDIM

Nr.3 datë 01.12.2020

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR TË PËRROIT TË "VOKOPOLËS", DEGË E LUMIT OSUM, BASHKIA MEMALIAJ, POLIÇAN, SKRAPAR QARKU GJIROKASTËR DHE BERAT, NGA SHOQËRIA "VOKOPOLA ENERGJI" SHPK, PËR HEC VOKOPOLA 3, PËR PRODHIM HIDROENERGJIE.

Në mbështetje të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.111/2012, i ndryshuar me ligjin 6/2018, datë 8.2.2018, për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore" VKM nr. 221, datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", si dhe të VKM Nr.416, datë 13.5.2015 si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 6 datë 12.6.2019, "Për miratimin e rregullores", "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" për pajisjen me leje të subjektit "Vokopola Energji" sh.p.k me propozim të Z.A.B.U. Shkumbin-Seman.

Këshilli i Basenit Ujor Seman

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes , për përdorimin të burimit ujqor të Vokopolës, degë e lumit Osum, për prodhim hidroenergjie, nga subjekti " Vokopola Energji" sh.p.k në Bashkinë Memaliaj, Poliçan, Skrapar, Qarku Gjirokastër dhe Berat.
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujqor Shkumbin-Seman për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU SEMAN



BAKI BALA